




|                                                                                     |                                 |
|-------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO                         |                                 |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                 |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.                                                                | Nr Prot.<br>Bi Prot.<br>Prot No |
| 20/DPK                                                                              | 01-5020/14                      |
| Nr. foli<br>Broj stranica<br>Nr. pages                                              | Data<br>Datum<br>Date           |
| 02                                                                                  | 26.12.2014                      |
| SHITINE                                                                             |                                 |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr.AKK-03-4265/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Menduh Abazi, Drejtor ne Postën e Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-4265/14, qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Menduh Abazi, Drejtor në Postën e Kosovës.**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Menduh Abazi, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, Drejtor në Postën e Kosovës është i angazhuar në veprimtari private si pronar dhe person i autorizuar, në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.11.2014, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit, dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Menduh Abazi, ka ardhur në takim ku është takuar me zyrtarët e AKK-së, dhe i janë prezentuar faktet që disponon Agjencia lidhur me dyshimin për konflikt të mundshëm të interesit.

z. Abazi, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por na ka njoftuar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe ka mbetur vetëm si biznes i regjistruar në ARBK, dhe është zotuar se brenda afatit ligjorë do ta bëjë shuarjen e këtij biznesi pasi që edhe faktikisht nuk zhvillon aktivitet.

Me datën 18.12.2014, kemi marrë njoftimin zyrtar nga ARBK-ku dëshmohet se është bërë shuarja vullnetare e biznesit me emër "A.T. Skylinestravel" dhe nr. biznesi 70220896.

Vlerësojmë se pas ndryshimeve të bëra në biznes, dhe pas rrethanave të krijuara konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin z. Menduh Abazi Drejtor në Postën e Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

